



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
FIER

Nr. 168 Prot.

Datë 19 / 12 / 2023

URDHËR

NR. 58, DATË 19 / 12 / 2023

**PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT TË MONITORIMIT/KONTROLLIT TË
RREGULLIT DHE SIGURISË NË PROKURORINË FIER**

Në mbështetje të nenit 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit të Procedurës Penale, neneve 41, 42, 57, 60, 62, 63 e 64 të ligjit nr. 97/2016, datë 06.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Rregullores Standarte për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë, si dhe aktve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim garantimin e rregullit e sigurisë dhe mirëfunksionimin e veprimtarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, etj;

URDHËROJ:

1. Të ngrihet komisioni i posaçëm për monitorimin/garantimin e rregullit dhe sigurisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me përbërjen si më poshtë:
 - Z. Petrit Vukaj, drejtues seksioni, bashkëkryetar.
 - Znj. Gëzime Kondakçiu, kryesekretare, bashkëkryetar.
 - Znj. Besian Milo, anëtare.
 - Znj. Mirketa Ndreko, anëtare.
 - Znj. Majlinda Shkurta, anëtare.
 - Znj. Mimi Doga, anëtar.
2. Komisioni ka detyrë të mbikëqyrje/monitorojë në vijimësi zbatimin e kushteve dhe kritereve ligjore/nënligjore dhe marrë masat mbrojtëse të nevojshme në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për:
 - garantimin e rregullit dhe sigurisë në Prokurorinë Fier;
 - garantimin e ruajtjes dhe sigurisë së godinave, ambienteve dhe zonave të sigurisë së Prokurorisë Fier dhe ish Prokurorisë Lushnjë gjatë dhe pas orarit zyrtar të punës;

- garantimin e administrimit dhe ruajtjes së provave materiale;
- garantimin e administrimit dhe ruajtjes së arkivës së Prokurorisë Fier (përfshirë edhe pjesën e arkivës në ish godinën e Prokurorisë Lushnjë dhe transferimin e saj sipas akteve ligjore/nenligjore ne fuqi);
- garantimin e administrimit dhe ruajtjes së aktiveve të prokurorisë;
- garantimin e vendosjes dhe funksionimit pandërprerë të sigurisë elektronike në godinën/ambinetet dhe zonat e Prokurorisë Fier dhe ish Prokurorisë Lushnjë, përfshirë pajisjet, mjetet dhe sistemet e vëzhgimit, sinjalizimit e kontrollit, etj.

3. Për problematikat e konstatuara në vijimësi nga komisioni i posaçëm të njoftohet drejtuesi i prokurorisë, së bashku me propozimet konkrete dhe projekt aktet e nevojshme të hartuara për të garantuar sigurinë dhe rregullin në Prokurori, sipas pikës 2 të këtij urdhëri.

4. Me këtë urdhër të njihen të gjithë pjestarët e komisionit të posaçëm.

5. Të administrohet një kopje e këtij urdhëri në aktet e fashikullit të drejtuesit të Prokurorisë.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Prokurorisë Fier.

DREJTUESI I PROKURORISË

Elion MUSTAJ

